



Ref. jonë. Bdk/pla

Lozanë, dhjetor 2018

Regjistrimi i fëmijës suaj në vitin e 1^{të} të arsimit të detyrueshëm që fillon në gusht 2019

Ju nuk flisni frëngjisht ?

*Kjo letër gjendet e përkthyer në shumë gjuhë në sitin e Internetit të qytetit të Lozanës :
www.lausanne.ch/thematiques/scolarite-lausanne.html*

Shkurt, çfarë duhet të bëni ?

Të plotësoni formularin vetjak bashkëngjitur për

- ✓ Të konfirmuar regjistrimin e fëmijës suaj në shkollë – ose për të na informuar për mënyrën e shkollimit të zgjedhur
- ✓ Të kontrolluar të dhënat administrative
- ✓ Për të na dhënë informacione të dobishme për caktimin e klasës së fëmijës tuaj

→ e të na i ktheni formularin para 14 janarit 2019, afati i fundit !

Zonjë, Zotëri,

Në muajin gusht të ardhshëm, fëmija juaj do të jetë në moshë për të filluar shkollën dhe ne gëzohemi që të kemi mundësinë ta presim në njerën prej klasave lozaneze.

Në fakt, siç e dini pa dyshim, fëmijët që kanë mbushur **4 vjeç në 31 korrik** hyjnë në shkollën publike, që është pa pagesë dhe e detyrueshme. Ligji kantonal mbi arsimin e detyrueshëm (LEO), në nenin 54 të tij, parashikon se «*të gjithë prindërit me banim të përhershëm apo të përkohshëm në kanton kanë të drejtën dhe detyrën që t'i regjistrojnë dhe t'i dërgojnë në një shkollë publike ose private fëmijët e tyre që kanë mbushur moshën e arsimit të detyrueshëm, apo t'u sigurojnë atyre arsimimin në banesë*».

Bashkë me këtë letër, ju do të merrni edhe një formular vetjak për ta plotësuar dhe për ta kthyer me anën e zarfit bashkëngjitur para **14 janarit 2019 afati i fundit**.

1. Ai lejon **konfirmimin e regjistrimit** të fëmijës suaj në shkollën publike të Lozanës. Me datë dhe nënshkrim, ky formular përbën regjistrimin zyrtar të fëmijës suaj.

Në rast se ju nuk dëshironi ta regjistroni fëmijën tuaj në shkollën publike të rregullt, ju duhet të saktësoni mënyrën e shkollimit që do t'i jepet (përmes një shkolle private, në një ent të arsimit të specializuar apo në banesë). Nëse kërkon shtyrjen e hyrjes së tij në shkollë për një arsye mjekësore të rëndësishme, duhet ta përmendni.

2. Ky formular lejon gjithashtu **kontrollimin e të dhënave administrative** që kanë të bëjnë me ju. Ju duhet të korrigjoni informacionet e pasakta në kolonën e djathtë. Në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave vetjake, vetëm informacionet e dhëna në ngjyrë **hiri** (Mbiemri, emri, etj.) janë të detyrueshme. Ndërkaq, për një komunikim të mirë midis shkollës dhe familjeve, **të gjitha janë shumë të dobishme**.

NB: Informacionet e shtypura në lidhje me familjen tuaj janë nxjerrë nga regjistri i Kontrollit të banorëve. Në rast gabimi, lutemi t'i drejtoheni Kontrollit të banorëve (Port-Franc 18) për të bërë korrigjimin.

3. Ky formular ju lejon gjithashtu të na jepni **informacione të dobishme për ndarjen e nxënësve** në klasat dhe ndërtesat shkollore lozaneze.
Veç afërsisë së banesës, dy kritere merren parasysh brenda mundësisë: vendi i pritjes ditore më i shpeshtë gjatë javës/ose vendi i shkollimit i vëllezërve dhe motrave (nëse janë në fillore).

Ftesë në një seancë informimi

Përfitojmë nga dërgimi i kësaj letre për t'ju njoftuar se seanca e informimit do të organizohet **më 29 prill 2019** në mbrëmje prej drejtoreshave dhe drejtorëve të enteve fillore lozaneze dhe shërbimeve të Qytetit. Një fletë-thirrje do t'ju vijë më vonë.

Orari i shkollës dhe kujdestaria jashtë orarit shkollor

Në Lozanë, mësimi kryhet çdo paradite nga ora 8.30 deri në 11.50 dhe nuk ka mësim pasdite për nxënësit e vitit të parë (1P).

Jashtë këtyre orareve, për të lejuar pajtimin e punës me jetën familjare, Qyteti ka ngritur struktura pritjeje parashkollore. Këto struktura nuk varen nga shkolla, por bëjnë pjesë në rrjetin lozanez të pritjes ditën, Rrjeti-L, i administruar nga shërbimi i pritjes ditore të fëmijëve (SAJE). Dy mundësi ekzistojnë :

- **Për fëmijët që tashmë përfitojnë nga kujdestaria në njërin prej strukturave parashkollore të Rrjetit-L, dosja e tyre do t'i ndjekë** : ndërkohë prindërit duhet të saktësojnë nevojat e tyre në drejtorinë e strukturës së pritjes të sotme.
- **Për fëmijët që nuk përfitojnë ende nga kujdestaria në Rrjetin-L**, prindërit mund ta regjistrojnë fëmijën e tyre pranë zyrës së informimit të prindërve (www.lausanne.ch/bip).

Informacion për caktimin përfundimtar të klasës së fëmijës tuaj

Kolegji dhe klasa ku do të shkollohet fëmija juaj, si dhe emri i(e) mësuesit(es), do t'ju konfirmohen me letër zyrtare në fillim të muajit korrik.

Keni pyetje? Jemi në dispozicion ! Takim në sitin tonë të Internetit : www.lausanne.ch/scolarite ose na kontaktoni në numrin 021 315 64 11.

Në pritje të përgjigjes suaj, ju dërgojmë, Zonjë, Zotëri, përshëndetjet tona më të mira.

Shefja e shërbimit

Barbara de Kerchove

Aneksat : formulari i regjistrimit

Kopje : Zonjat dhe Zotërinjtë drejtoresha dhe drejtorë të enteve fillore lozaneze
Shërbimi i pritjes ditore të fëmijëve (SAJE)